



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT
JAVA 15
07 Prill – 13 Prill 2025

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 Njesi Vendore te Kujdesit Shendetesor (NJVKSH) ose 100% (=36/36) e tyre.

Tabela 1. Plotësimi i formularit ALERT sipas cdo NJVKSH

Përqindja e plotësueshmërisë				
Rajoni	Qarku	Njvksh	Nr. Qendrave	%
TIRANË	Tiranë	Tiranë	35 / 36	97%
		Kavajë	8 / 10	80%
	Durrës	Durrës	20 / 20	100%
		Krujë	6 / 6	100%
	Dibër	Dibër	16 / 16	100%
		Mat	13 / 13	100%
		Bulqizë	9 / 9	100%
ELBASAN	Elbasan	Elbasan	27 / 27	100%
		Librazhd	11 / 11	100%
		Gramsh	8 / 8	100%
		Peqin	6 / 7	86%
	Korçë	Korçë	20 / 20	100%
		Pogradec	9 / 9	100%
		Devoll	6 / 6	100%
		Kolonjë	4 / 4	100%
	Berat	Berat	15 / 15	100%
		Kuçovë	4 / 4	100%
		Skrapar	6 / 6	100%
SHKODËR	Shkodër	Shkodër	6 / 19	32%
		M. Madhe	6 / 6	100%
		Pukë	10 / 11	91%
	Kukës	Kukës	14 / 14	100%
		Has	5 / 5	100%
		Tropojë	9 / 9	100%

	Lezhë	Lezhë	11 / 11	100%
		Kurbin	5 / 5	100%
		Mirditë	8 / 8	100%
VLOREË	Vlorë	Vlorë	20 / 20	100%
		Sarandë	9 / 9	100%
		Delvinë	5 / 5	100%
	Fier	Fier	20 / 20	100%
		Lushnjë	18 / 18	100%
		Mallakastër	9 / 9	100%
	Gjirokastër	Gjirokastër	21 / 21	100%
		Përmet	8 / 8	100%
		Tepelenë	7 / 7	100%
		TOTAL	414 / 432	96%

Tabela 2. Numri Total i Rasteve të Sindromave të Survejancës “Alert” në Javën 15

	JAVA 15
Diarre pa gjak	1427
Diarre me gjak	0
Inf. Resp. te sipërme	7871
Inf. Resp. te poshtëme	3379
Rash me temperaturë	26
Verdheza	0
Ethe e zgjatur e pashpjeguar (> 3 jave)	0
Anomali kongenitale	0
Konjuktivit akut tek neonatët	0
Numri i Njësive Raportuese	414
% e Njësive Raportuese	96% (414/432)

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog rastet e mëposhtëme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për varicelë:



Kurbin – 3 raste

Mat – 1 rast

Fier – 8 raste


Tiranë – 11 raste

Pogradec – 3 raste


Grafiku 1. Prirja në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve**Grafiku 2. Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave**

Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet rritje në javën 15 krahasuar me javën paraardhëse, java 14.

Grafiku 3. Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Grafiku 4. Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e “Diarre pa gjak” paraqet rritje në javën 15 krahasuar me javën paraardhëse, java 14.

Grafiku 5. Krahاسimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000




Grafiku 6. Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 01 - 15 të sezonit 2023-2024 dhe sezonit 2024-2025. Numri i rasteve.




Në javën 15 të vitit 2025 vërehet një rritje e numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme.


Grafiku 7. Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000)



Grafiku 8. Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas NJVKSH në javën 14 dhe 15/ 2025. Incidenca (raste/10.000)




Grafiku 9. Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët 01 - 15 të sezonit 2023-2024 dhe sezonit 2024-2025. Numri i rasteve



Në javën 15 vërehet prirje në rritje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”, këtë vit vërehet një numër me i larte i këtyre infeksioneve krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 10. Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH në javën 14 dhe 15/ 2025. Incidenca (raste/10.000)



Rritja e numrit të rasteve me diarre në javën 15 në Tepelene, krahasuar me javën e kaluar, lidhet me faktin se gjatë javës 14 një nga qendrat e ALERT në Tepelenë nuk ka raportuar.

Ngjarje kombëtare

Gripi i shpendëve -përditësim i situatës në vendin tonë

Nga data 30.10.2024 -14.04.2025 numri vatrave të gripit të shpendëve në shpendë të raportuara në njoftimin e menjëhershëm nga MBZHR rezulton në 11. Nga përditësimi i fundit datë 14.04.2025 nuk ka raportime për vatra të reja të identifikuar në shpendë, shpërthimi në 2 kapanone të stabilimenteve REAS dhe AIBA të raportuara më datë 08.04.2025 në pula për vezë dhe zogj, vijojnë të jenë aktive.

Nga monitorimi i kryer në këto stabilimente nga grupet e punës në terren janë marrë 30 kampione material patologjik për ekzaminim tampon nga kloaka dhe trakeja, të cilët kanë rezultuar Pozitiv për A(H5N1) me metodën molekulare Molekulare RT-PCR

Tabela 3. Numri i vatrave të raportuara në shpendë për periudhën 30.10.2024 - 06.04.2025

Njvks	Nr.vatrave total	Vendndodhja	Lloji i shpendëve të prekur
Tiranë	4	Kodër -Mëzez /zalt	Pulë fushe
		Zall-Herr	Pulë deti
		Babrru qendër	Pulë fushe
		Pakuqan	Pulë fushe
Vlorë	2	Plazhi vjetër	Shpend i egër /pulëbardhë
		Laguna Nartë	Shpend i egër Pelikan/patë e egër
Lushnjë	1	Laguna Karavasta	Pulëbardhë kembë verdhë
Gjirokastrë	1	Lunxhëri/Valare	Pulë fushe
Durrës	3	Rrashbull/Reas	Pula/prodhimi /veze
		Kulle/Sukth	Pulë fushe
		Rrashbull /Aiba	Pula prodhimi/zogj
Total	11		

Testimi dhe Diagnostikimi në shpendë

Nga ISUV janë raportuar (30 **Mostra**) të marra në shpendë, të cilat kanë rezultuar Pozitiv për Influenca Aviare A(H5N1).

Testimi dhe Diagnostikimi në njerëz

Nga NJVKSH Durrës që nga fillimi i shpërthimeve janë marrë për depistim të punonjësve të pularive Aiba dhe Reas (shpërthim pule oborri në fshatin Kullë. Në total 80 mostra nga të cilat 40 i përkasin punonjësve të AIBA 39 Reas dhe 1 mostër familje (fshati Kulle). Të gjitha mostrat e testuara në ISHP kanë rezultuar negative për gripin e shpendëve.

Sindromi dorë-këmbë- gojë -Lezhë

Më datë 08.04.2025 NJVKSH Lezhë u njoftua nga drejtoresha e cerdhes së qytetit për 2 fëmijë me rash kutan në ekstremitete fillimisht të dyshuar për varicelë. U krye menjëherë hetimi pranë cerdhes nga grupi i epidemiologjisë ku 2 fëmijët paraqisnin rash në zonën e shputave të këmbëve, pëllëmbët e duarve dhe zona periorale. U dyshua sindromi dorë-këmbë-gojë dhe pas komunikimit me mjekun pediatër. U krye inspektimi i të gjithë fëmijëve të cerdhes të atij grupi dhe të grupeve të tjera. U konstatuan 5 fëmijë të tjerë me klinike të ngjashme. U njoftuan prindërit në lidhje me karantinimin dhe testimin e fëmijëve.

Më dt 09.04.2025, u morën mostra tampone orale dhe rektale nga të 7 fëmijët që paraqiten shenja klinike. Mostrat u dërguan në ISHP për tu testuar pranë laboratorit të virologjisë.

Stafit të edukatorëve iu la detyrë të lajmërojnë menjëherë nëse konstatojnë një rast të ri.

Në total u analizuan 7 tampone orale të marra në fëmijët e dyshuar me HFMD, mostrat u analizuan me anë të metodës RT_PCR për Enterovirus në total. Nga 7 mostrat vetëm 2 prej tyre rezultuan pozitiv për Enterovirus.

Nga monitorimi i përditshëm në cerdhe nuk ka patur asnjë rast të ri.

Rast brucelozë në kafshë- Berat

Në dt.07/04/2025, përgjegjësi i Shërbimit Veterinar, Berat njoftoi NJVSH për 2 krerë (lopë) pozitiv me Brucelozë në fshatin Pëllumbas.

Nga komunikimi me inspektorin e shërbimit veterinar rezulton se në fermë ka 10 krerë në total (gjedhë). Aktualisht ferma është karantinuar dhe asnjë nënprodukt nuk është tregtuar. Ferma menaxhohet nga vetë familjarët. Grupi i epidemiologjisë kreu hetimin në vatër. Ferma menaxhohej nga dy persona , të cilët kishin patur kontakt me kafshët e sëmura. Të dy ishin në gjendje të mirë

shëndetësore dhe nuk shfaqnin shenja. Te dy personave iu mor mostra për tu testuar që rezultuan negativ për brucelozë.

Në familje ishin dhe 4 pjesëtarë tjetër të cilët gjithashtu ishin pa shenja.

Qumështi i gjedhëve të sëmura nuk ishte konsumuar nga asnjë person.

Gjatë javës në vazhdim situata do të jetë në monitorim të gjendjes shëndetësore të personave të kontaktit në këtë fermë.

Ngjarje ndërkombëtare

Influenza A(H5N1) – Shumë shtete (Botë) – Monitorimi i rasteve në njerëz

- Rasti i parë në njerëz i gripit të shpendëve A (H5N1) në Meksikë vdiq më 8 prill 2025.
- Pacienti, një fëmijë tre vjeçar nga shteti i Durangos, doli pozitiv në 1 Prill 2025 dhe u shtrua në spital në gjendje të rëndë.
- Autoritetet kanë filluar veprimet e synuara të reagimit epidemiologjik dhe mjedisor.
- Deri më sot, 38 kontakte njerëzore të rastit janë marrë në mostër dhe të gjitha janë testuar negative.
- Që nga viti 2003 dhe deri më 9 prill 2025, ka pasur 972 raste njerëzore të A(H5N1) në mbarë botën, duke përfshirë 470 vdekje.

Koronavirusi i sindromës së frymëmarrjes në Lindjen e Mesme (MERS-CoV) – Shumë vende

- Që nga përditësimi i mëparshëm më 18 mars 2025 dhe që nga 7 prilli 2025, asnjë rast i ri MERS-CoV nuk janë raportuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ose autoritetet kombëtare shëndetësore.
- Që nga fillimi i vitit 2025 dhe që nga 7 prilli 2025, është raportuar një rast MERS me datë të fillimit në vitin 2025 në Arabinë Saudite.
- Rreziku i transmetimit të qëndrueshëm nga njeriu te njeriu në Evropë mbetet shumë i ulët dhe situata aktuale MERS-CoV paraqet një rrezik të ulët për BE/EEA.

Sëmundja autoktone e virusit chikungunya - Réunion dhe Mayotte, Francë, 2024-2025

- Në gusht 2024, Franca raportoi rastin e parë autokton të sëmundjes së virusit chikungunya në 10 vjet në Réunion, me fillimin e simptomave më 12 gusht.
- Që atëherë dhe deri më 30 mars 2025, 27 668 raste autoktone të sëmundjes së virusit chikungunya janë konfirmuar në Réunion.

- Më 21 mars 2025, u raportuan dy vdekje në individë të moshuar me sëmundje shoqëruese.
- Haute Autorité de Santé (HAS) ka këshilluar vendimmarrësit publikë që të vaksinonjë grupet që janë në rrezik më të lartë të sëmundjeve të rënda dhe profesionistëve të kontrollit të vektorëve. Agjencia rajonale e shëndetësisë po përgatitet të sigurojë aksesin e vaksinave për individët me prioritet që nga fillimi i prillit.
- Më 26 mars 2025, u raportua një rast autokton i sëmundjes së virusit chikungunya në Majota.

Sëmundja Ebola – Uganda – 2025

- Që nga përditësimi i fundit, dhe që nga 10 prilli, nuk është raportuar asnjë rast i ri me Ebola. Të gjitha rastet kanë dale nga spitali dhe nuk ka kontakte aktive në ndjekje.
- Numërimi mbrapsht për shpalljen e shpërthimit të mbaruar filloi më 15 mars, në vijim të shkarkimi i pacientit të fundit që trajtohet. Që nga 10 prilli, 26 ditë nga numërimi 42-ditor periudha kishte përfunduar.
- Që nga fillimi i shpërthimit dhe që nga data 10 prill, 12 raste të konfirmuara dhe dy raste të mundshme janë raportuar, duke përfshirë katër vdekje (dy raste të konfirmuara dhe dy raste të mundshme). Totali i numrit të individëve që janë shëruar është 10 (83%).
- Qytetarët e BE-së/ZEE-së që punojnë në mjediset e kujdesit shëndetësor në Ugandë duhet të jenë të vetëdijshëm për vazhdimin e shpërthimit dhe marrjen e masave të duhura mbrojtëse personale.
- Në dritën e dëshmimeve nga shpërthimet e mëparshme më të mëdha, importimi i sëmundjes në BE/EEA nëpërmjet dikujt me infeksion ka shumë pak gjasa dhe, nëse kjo ndodh, probabiliteti i transmetimit të mëtejshëm konsiderohet shumë i ulët.